

Linz, 19.03.2024

Lënda: Të drejtat e personave që ndihmojnë në vjelje dhe punonjësit deh punonjëset bujqësor në ndërmarrjet bujqësore

I nderuar anëtar i dhomës,


Dhoma e punonjësve të bujqësisë së Austrisë së Sipërme (OÖ LAK) është përfaqësia e interesave për të gjithë punëdhënëset dhe punëdhënësit në bujqësi dhe në pylltari në Austrinë a Sipërme. Kush punësohet me një marrëdhënie shërbimi në një ndërmarrje bujqësore në Austrinë a Sipërme, është automatikisht anëtar i dhomës së OÖ LAK. Ne dëshirojmë që në bashkëpunim me të gjitha autoritetet (shërbimi i tregut të punës, sigurimet shëndetësore të Austrisë, policinë financiare dhe inspektoriatin i bujqësisë dhe pylltarisë) të parandalojmë ankesat në sektorin e punës sezonale në bujqësi dhe prandaj ju informojmë juve mbi të drejtat tuaja për sa i përket pagesës, mbrojtjes së punëmarrësve dhe standardin minimal të banesave. Detyra kryesore e OÖ LAK është **mbështetja falas** e anëtarëve të dhomës në çështjet e kodit të punës.

Për të gjitha marrëdhëniet e punës së personave që ndihmojnë në vjelje vlejné parimet e mëposhtme:

1. **Paga minimale** mujore (bruto) në varësi të marrëveshjes së pagës së bërë
 - € 1.712,00 për personat që ndihmojnë në vjelje, për punëtorët sezonalë
 - € 1.716,00 për punonjësit e bujqësisë

Nëse paguhet më pak se paga minimale, punëdhënësve i kanosen gjoba të larta.

2. Punëmarrësve i duhen dorëzuar **dokumente të ndryshme pune**. Kushtoni vëmendje sidomos, që juve
 - me fillimin e marrëdhënies së shërbimit t'ju dorëzohet regjistrimi te siguracioni shëndetësor Austriak
 - dhe çdo muaj një listë-pagesë.



3. Çdo punëmarrës posedon të drejtën që çdo vit të përfitojnë dy pagesa të veçanta („Pagën mujore të 13-të dhe 14-të“) me vlerën e një page mujore. Pa marrë parasysh kohëzgjatjen e punësimit, pagesat e veçanta i takojnë në çdo rast pjesërisht.
4. **Koha normale** javore e punës në rastin e punësimit të plotë është **40 orë**. Për orët shtesë që kalojnë përtej këtyre i takon normalisht edhe një shtesë mbi pagesën për orë.
5. Punëdhënësit janë të detyruar që të **mbajnë shënim orët e punës**. Sigurohuni që këto shënime t’ju dorëzohen dhe mbani gjithashtu edhe shënime vetjake me shkrim dorë mbi fillimin dhe përfundimin e kohës ditorë të punës si dhe pushimet e respektuara të punës.
6. Ju posedoni të drejtën për pesë javë **pushime** të gabuara për çdo vit pune. Për pushime që nuk keni konsumuar, në fund të marrëdhënies së punës ju takon një kompensim („Shpërblim për zëvendësimin e ditëve të pushimit“.)
7. Në rastin e një **sëmundje** ju posedoni të drejtën për një vazhdim të pagesës së pagës për një periudhë kohore për një periudhë të caktuar kohore. Sëmundjen duhet t’ia bëni me dije menjëherë punëdhënësit. Në çdo mosmarrëveshje ju duhet të jeni në gjendje të vërtetoni që ju e bërë këtë raportim. Me kërkesë të punëdhënësit duhet të paraqitet një raport mjekësor për paaftësinë në pune. Raportet mjekësore të huaja duhet që ju vetë ti paraqisni brenda një javë pranë siguracionit shëndetësor austriak ose t’ia transmetoni atë asaj, përndryshe nuk mund të kryhet pagesa e parave kur ju jeni i sëmur.
8. Për sa kohë juve ju vendoset në dispozicion një banesë nga punëdhënësi, duhet që kjo e fundit të jetë në përputhje me një standard normal të vendit ku jeni strehuar. Informacione më të detajuara në lidhje me këtë gjë mund të gjeni në fletën informuese bashkëlidhur.

Keni pyetje ose ju nevojitet ndihmë në realizimin e të drejtave tuaja? Na u drejtoni neve në: **Numri i telefonit 0732 656 381-0**

Kontakt:
OÖ Landarbeiterkammer
Scharitzerstraße 9
4020 Linz

Tel.: 0732 656 381-0
Fax: 0732 656 381-29
e-mail: office@lak-ooe.at
<https://www.lak-ooe.at/>

Consultation by appointment
only (in German or English).